



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 836/L prot.

Pukë, më 13.05. 2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim Relacioni dhe Projekt-Vendimi

KËSHILLIT BASHKIAK PUKË

Të nderuar, këshilltarë!


Bashkëlidhur, ju dërgojmë për shqyrtim Relacionin dhe Projekt-Vendimin nr.02, datë 13.05.2025

“Për Dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (Pas Vdekjes) i Bashkisë Pukë Z. Mark Preng Ndoj”.

Faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI

Rrok DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 036/1 prot.

Pukë, më 13.05.2025

RELACION

Mbi

PROJEKT VENDIMIN

Nr. 02, datë 13.05.2025

PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' (Pas vdekjes) I BASHKISË PUKË

Z. MARK PRENG NDOJ

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa "m"; ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, sjellim për miratim këtë projektvendim, i cili është vijimësi e vlerësimit të disa figurave që kanë lënë gjurmë me rolin dhe kontributin e tyre, duke i shërbyer atdheut dhe kombit në rrugën e tij drejt zhvillimit dhe prosperitetit.

Emri i z.Mark Ndoj, i propozuar për dhënie e titullit "Qytetar Nderi" (Pas vdekjes) i Bashkisë Pukë, pasi ka kaluar Komisionin Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, paraqitet sot për këtë vlerësim, duke çmuar rolin e tij prej një atdhetari të vërtetë, i cili nuk kurseu asgjë në dobi të vlerave kombëtare dhe kontributit për dije e arsim.

Nisur nga rol, i faktuar përmes veprave konkrete, dëshmime të lëna nga bashkëkohësit dhe artikujve të botuar në organe të ndryshme (bashkëlidhur) ju ftoj t'a votoni këtë projekt-vendim!

Bashkëlidhur:

1. PROJEKT VENDIMI, Nr. 02, datë 13.05.2025

PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' (PAS VDEKJES) I BASHKISË PUKË Z. MARK PRENG NDOJ.

2. Dokumentacioni njohës mbi jetën dhe veprën e tij.

3. Miratimi i Komisionit Këshillimor.

Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Sokol Gjoni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 836 prot.

Pukë, më 13.05. 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 2 datë 13.05. 2025

PËR

DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” (PAS VDEKJES) I BASHKISË PUKË

Z. Mark Preng Ndoj

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë _____.05.2024;

Vendosi:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” (Pas vdekjes) i Bashkisë Pukë.

Z. MARK PRENG NDOJ

Me motivacionin:

“Për rolin dhe kontributin e tij të çmuar atdhetar e patriotik, duke vënë në shërbim të kombit gjithçka që zotëronte, përfshirë edhe shtëpinë e tij të kthyer në shkollë në Kaftallë, për përhapjen e dijes dhe të gjuhës shqipe.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

Paraqiten projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Endrit Kraja

Kryetari

Rrok Dodaj



Mark Preng Ndoj (Çoku)

Lindi në Korthpul të Mirditës më 06/01/1921. Ai ishte një patriot dhe atdhetar i shquar nga fshati Kaftall, Mirditë. Ishte një figurë emblematike që vuri në shërbim të kombit gjithçka që zotëronte për përhapjen e dijes dhe gjuhës shqipe. Origjina e Mark Prengës është nga Oroshi i Mirditës. Ata dolën nga Oroshi për në Kaftall dhe ngritën kullën historike, e cila u ndërtua nga paraardhësit e tij, Nikoll Pjetër Çoku, rreth vitit 1620. Kjo kullë shërbeu për breza si simbol i besës, trimërisë dhe mikpritjes së kësaj familjeje fisnike.

Në vitin 1946, mësuesi i popullit Ndrec Ndue Gjoka i kërkoi Ministrit të Arsimit: “50 shkolla në Mirditë i dua!” – “Të lumtë goja, mirë ke menduar.” Ndreca shkoi fshat më fshat në gjithë Mirditën, duke kërkuar ndihmë për hapjen e shkollave, ku analfabetizmi ishte mbi 90%.

Në këtë kohë, Marka Preng Ndoj (Çoku) mori vendimin për të lëshuar shtëpinë si shkollë për të mësuar fëmijët e fshatit shkrim dhe lexim. Në vitin 1946, kjo shtëpi ishte shkolla e parë shqipe në Kaftall. Kjo shtëpi-shkollë mirëpriti fëmijët dhe të rinjtë e zonës, duke funksionuar me dy turne: paradite për mësimin e fëmijëve të vegjël dhe pasdite për kurse kundër analfabetizmit për të rriturit.

Në këtë shkollë të parë shqipe në Kaftall, mësuesi i parë Gjok Kaçorri dha mësim dhe dha një kontribut të madh, duke iu shërbyer familjeve. Pasi përfundonte mësimin me fëmijët, pasdite vazhdonte me moshat e rritura. Ai kishte mbështetjen e Mark Prengës për të gjitha punët dhe nevojat, në mënyrë që të lehtësohej puna e tij.

Përkushtimi i Mark Preng Ndoj (Çoku) ndaj shkollës ishte i jashtëzakonshëm dhe i bazuar në humanizëm të pastër. Familja e Markut u kujdes për rregullin, pastërtinë, sigurimin e ujit të pijshëm dhe druve të zjarrit për ngrohje. Ata ndihmonin edhe gjatë ditëve të vështira me shi, akull dhe borë, që fëmijët të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Të gjitha këto, kjo familje i bëri pa pagesë, por me një ndjenjë të thellë humanizmi ndaj kombit dhe gjuhës shqipe. Shkolla e parë shqipe në Kaftall ka funksionuar deri në vitin 1950. Pas kësaj, u ndërtua shkolla e re në qendër të fshatit Kaftall. Kontributi i Mark Preng Ndojt (Çoku) mbeti i paharruar për shkollën e tij të parë

në Kaftall. Në njërën nga dhomat e shkollës së re u ngrit një muze i veçantë për të ruajtur kujtimet e kësaj periudhe historike, duke përfshirë fotot dhe dëshmitë e asaj kohe.

Mark Preng Ndoj, për t'iu përgjigjur thirrjes së Partisë për të shkuar në aksion dhe për të punuar për hapjen e kënetës së Maliqit në Korçë, dërgoi vëllain e tij, Frrok Preng Ndoj. Ai dha një kontribut personal në hapjen dhe tharjen e kënetës. Puna ka filluar në vitin 1946 dhe ka përfunduar në vitin 1952, duke bërë këtë kënetë më të madhen në Shqipëri.

Në vitin 1970, ka filluar punë në Hidrocentralin e Vaut të Dejës dhe më pas në Hidrocentralin e Komanit dhe në Hidrocentralin e Fierzës. Gjithashtu, ka punuar në kantierin e çimentimit, ku ka dhënë një kontribut personal si specialist në këto tre vepra më të mëdha në Shqipëri.

Në vitin 1967, qeveria e asaj kohe mori vendimin për të krijuar kooperativat bujqësore në të gjitha zonat e veriut, dhe në zonën tonë u krijua Kooperativa Bujqësore e Korthpules. Në atë kohë, qeveria dërgoi ndihmës-mjek dhe agronom për të ndihmuar kooperativën bujqësore. Marka Preng Ndoj (Çoku) ishte i gatshëm t'i strehojë ata në shtëpinë e tij, duke dhënë një shembull shumë pozitiv. Çdo shërbim që është bërë për ta nga Marka Preng Ndoj (Çoku) dhe familja e tij ishte në kuadrin e humanizmit dhe sakrificës, pa asnjë pagesë apo shpërblim. Këto veprime do të ngelin në histori për të gjithë ata që e kanë njohur Mark Prengën dhe për brezat në vazhdim.

Marka Prenga ka punuar në Kooperativën Bujqësore të sapo krijuar, duke dhënë një kontribut të madh si specialist ndërtimi për të gjitha punët dhe duke dhënë një shembull të veçantë. Mark Preng Ndoj (Çoku) vdiq më 23 mars 1990, duke lënë një trashëgimi, atdhedashuri dhe sakrificë jo vetëm për familjen e tij, por edhe për gjithë kombin.

Në ceremoninë e varrimit të Mark Preng Ndoj (Çoku), fjalën e rastit e përgatiti dhe e mbajti Nikoll Preng Kola (Gjoka), duke folur për historikun e Mark Prengës dhe meritat e tij. Nikolla mori respektin e të gjithë të pranishmëve për fjalën e rastit që mbajti në atë ceremoni varrimi.

Përkujtimi dhe respekti për të mbeten të gjallë në zemrat e pasardhësve të tij dhe të gjithë atyre që e njohën historinë e tij.

Janar 2025

MARK PRENG NDOJ (ÇOKU)

11 Nëntor, 2021

Lindi,jetoi dhe ndërroi jetë në fshatin Kaftallë,Korthpulë-MIRDITË.

Nga fisi i madh i Çokajve,me origjinë nga Oroshi i Mirditës.

Jeta e solli që pas Çlirimit shtëpisë së Markut ti vihet syri si objekt i përshtatshëm për shkollë.

Kërkesës së pushtetit të kohës,Mark Prengë Ndoj iu përgjigj pozitivisht pa pa asnjë mëdyshje.

Kështu,në mars 1946,kjo shtëpi u kthye në shkollë,e cila duhet theksuar punoi me dy turne për shumë vite

Turni i parë-paradite bëhej mësim me fëmijë të moshës 7,8,9 vjeçare.

Turni i dytë –pasdite vonë për rreth 3 orë bëhej kurs kundër analfabetizmit masiv me më të rriturit 13-30 e më shumë vjeç,SI DJEM VAJZA,TË RINJ E TË REJA,NUSE TË SAPOMARTUARA ETJ.

Mësuesi i parë në këtë shkollë shtëpi ishte Gjokë Kaçorri nga një fshat i Mirditës.i cili ishte i arsimuar në Konviktin e Oroshit.

E gjithë familja e Mark P.Ndojt i shërbente në një formë ose tjetër shkollës si për rregull,pastërti,siguri fizike të nxënësve por dhe mësuesit,ujë të pishëm,dru zjarri,përcjelljen për në shtëpi të fëmijëve të vegjel në raste të motit të keq apo për arsye të tjera si vajza të rritura që kishin larg shtëpinë,ndonjë fëmijë të sëmurë apo arsye tjetër,pa asnjë pagesë , por vullnetarisht,për humanizëm.

Bujaria,dashuria për dije respekti për të gjithë bashkëfshatarët pa dallime fisnore apo tjetër,sakrificat ishin tipare karakteriale të të gjithë pjesëtarëve të familjes së Markut.

Me kalimin e kohës ,shkolla u vendos në qendër të fshatit,por kurrë nuk u harrua gjesti shembullor i MARK P.NDOJT(ÇOKU).

Në një dhomë të shkollës u ngrit muzeu ku u pasqyrua deri në detaje me foto ,dëshmi,kujtime të ishnxënësve të shkollës së parë,foto të shtëpisë-shkollë,të Mark P.Ndoj.

Vizitorë të shumtë vinin dhe me nostalgji flisnin për shkollën e parë dhe fisnikërinë e Markut dhe familjes së tij .

Mark P. Ndoj dhe familja e tij kanë gëzuar një respekt të merituar nga bashkëfshatarët gjithë periudhën e kolektivizimit por dhe më mbrapa në demokraci ,falë qendrimeve e veprimeve korrekte të të gjithë pjesëtarëve të familjes së tij.

Marku,e shoqja Lezja,vëllai Frroku,dalloheshin për qendrim shumë dashamirës me bashkëfshatarët e të gjitha moshave e kategorive.Pavarësisht vështirësive dhe problematikës së jetës në kolektivizim,kjo familje në asnjë moment nuk u shmang nga qendrimet korrekte dhe të paanëshme.

Edhe dy djemtë e tij ZEFI dhe PRENGA me familjet e tyre asnjëherë nuk devijuan nga edukata familjare shembullore e prindërve të tyre.

Të gjithë nipat e mbesat e Markut ,kudo ku punojnë e jetojnë janë korrekt dhe të përgjegjshëm

Vajza e Prengës,djalit të dytë të Markut,KLEOPARTA ka mbaruar studimet e larta për gjuhë angleze , duke realizuar një dëshirë të zjarrtë të gjyshit të saj,MARKUT por edhe axhës FRROK,që çështjen e shkollimit e kishin dobësinë e tyre gjithë jetën.

Drejtori i Shkolles Kaftallë

Dede Bilani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KOMISIONI KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT VENDOR TË NDERIT

Nr. 236/2 prot.

Pukë, më 13.08 2025

MIRATIM

PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' (Pas vdekjes) I BASHKISË PUKË

Z. MARK PRENG NDOJ

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", si dhe VKB nr.70, datë 27.12.2024, "Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë"; pasi u njohëm me materialet dhe dosjen e plotë, përmes së cilës dokumentohet kontributi i z. Mark Preng Ndoj në shërbim të përhapjes së arsimit në vend, si dhe disa publikime në shtypin shqiptar dhe në mediat online, ku nënvizohen dhe shpalosen vlerat e një atdhetari që nuk kurseu asgjë në dobi të vendit, duke vënë në shërbim të arsimit të brezave shtëpinë e tij në Kaftallë që shërbeu për shumë vite si shkolla e parë e këtij fshati, shprehemi unanimisht për vlerësimin e tij të merituar nga Bashkia Pukë si "Qytetar Nderi", (Pas vdekjes).

KOMISIONI KËSHILLIMOR

1. Sokol Gjoni

2. Denisa Meçi

3. Endrit Kraja

4. Rasim Laçi

5. Ylli Hadroj